



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/ Ministarstvo za Kulturu, Omladinu i Sport
Ministry of Culture, Youth and Sports

Departamenti i Kulturës/ Departament Kulture /Department of Culture

DATË/A:	28.07.2009
REFERENC-Ë:	Z Salih Morina, Sekretar i Përherershëm i MKRS
PËR/ZA/TO:	
CC:	Z. Sami Piraj, Drejtor i DK, Znj. Burbuqe Bakia- Deva Udhë. E DTK.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	komisioni
/*TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Pranimi teknik i aktiviteteve konz. - res. Në Kalanë e Pogradjës


1.

Në bazë të vendimit nr. 2107 të datës 23.07.2009 të lëshuar nga Z. Salih Morina sekretar i Perherershëm i MKRS , formohet komisioni për pranim teknik të punimeve me rastin e përfundimit të aktiviteteve konservuese – restauruese në kalanë e Pogradjës në përbëjen : Enverrexha Drejtor i IAK

Jusuf Musa nga MKRS,
Lindita Cervadiku nga IMMI Prishtinës dhe
Milot Berisha nga IAK.

Komisioni në përbërje të plotë me përashtim të z. Milot Berisha i cili me arsyen mungoj {është duke udhëhequr gërmimet arkeologjike në një këndë të Ulpianës . Gërmimet janë duke u zhvilluar në kuadër të projektit Parku ndëretnik Ulpiana 2009}.

Komisioni udhoj me datë 23.07.2009 duke arritur në Kalanë e Pogradjës në ora 13. Në shoqërim të komisionit ishte z. Artan Hoxha drejtor i Qendrës për Trashëgimi në Gjilan



icili edhe ka qenë i ngarkuar me detyrën e mbikqyrësit të aktiviteteve konservuese - restauruese në kalanë e Pogradjës.

Komisioni kontrolloj me vëmendje qdo pjesë të objektit , u konsultua mesë vedi , u konsultua me z. Artan Hoxha si mbikqyrës , konsultoj projektin , dokumentin e tenderit dhe pas një vizite të detajizuarë të objektit dhe konsultimit të dokumentacionit erdhi në përfundimin si në vijim:

Komisioni në përbërje të plotë pranon punët konservuese - restauruese në pergjithësi të zhvilluara në Kalanë e Pogradjës . Objekti tani ka marrë një pamje të re si objekt arkitektonik, arkeologjik dhe perfaqsues i Trashëgimisë Kulturore në këto anë të Kosovës. Muret janë konsoliduar , janë konservuar dhe është krijuar një situatë që ato të mos dëmtohen nga natyra dhe poashtu do të mbrohen më mirë edhe nga dora e njeriut. Aktivitetet konservuese - restauruese janë mbikëqyrur vazhdimisht nga përfaqsuesi i MKRS dhe mund të themi se kryesisht vërejtjet janë zbatuar nga punëkryesi.

Komisioni pasi shqyrtoj raportin përfundimtar të mbikqyrësit erdhi në përfundim se ka edhe vërejtje të cilat do ti prezantojmë si të tila e që do mbesin si detyrim i domosdoshëm i punëkryesit e të cilat duhet ti mbaroj prej një afati prej 10. ditësh nga dita kur kryesi i aktivitetetve ta pranoj dokumentin e komisionit.

Vërejtje : Në pjesën veri- lindore të kalasë nuk është bërë konsolidimi i murit në një gjatësi prej tet metrave përafërsisht e që mbetet detyrim i domosdoshëm që të konsolidohet në mënyren si është bërë pjesa tjeter e mureve.

Në faqën me te madhe në pjesën – perendimore të kullës është filluar gabimisht aktiviteti i suvatimit me llaq, por meqenëse është vërejtur se është një gabim profesional menjëherë është ndërhyre dhe kanë bërë pastrimin e asaj shtrese, por megjithëate vërehen ndërhyrjet e tillë , prandaj komisioni e pranon këtë aktivitet të konservim – restaurimit dhe të aktiviteteve konservuese - restauruese të zhvilluara në Kalanë e Pogradjës me detyrimin e cekur më lartë.

Antaret e komisionit: Enver rexha Drejtor i IAK

Jusuf Musa nga MKRS

Lindita Ceryadiku nga IMMMMP

Milot Berisha nga IAK